

Commonwealth Ombudsman

Ombudsmani i Komonuelthit (Mbledhësi i Ankesave të popullit) është një person i pavarur që heton ankesat e bëra në drejtim të departamenteve të Qeverisë Australiane.

FUNKSIONI I OMBUDSMANIT

Ombudsmani mund të hetojë ankesa në lidhje me shumicën e agjencive të Qeverisë Australiane, duke përfshirë Centrelink, Zyrën e Taksave, Agjencinë e Child Support (Përkrahjes së Fëmijëve), Departamentin e Emigracionit si dhe Postën e Australisë.

Është në dorë të Ombudsmanit të vendosë nëse një veprim apo vendim në shqyrtim është i gabuar, i paarsyeshëm, i padrejtë apo diskriminues. Ai gjithashtu ka të drejtë të hetojë ndonjë vonesë ose mungesën e veprimit të administratës.

Nga ana tjetër, Ombudsmani nuk mund të hetojë ankesat në lidhje me personat privatë ose kompanitë, vendimet e gjykatave, apo veprimet ose vendimet e shtetit apo qeverisë lokale, të ministrave të qeverisë ose të disa ndërmarrjeve shtetërore biznesi.

Ombudsmani është i paanshëm dhe i përkushtohet arritjes së një rezultati të drejtë.

Ombudsmani punon për të përmirësuar administratën publike me qëllim që të parandalojë përsëritjen e problemeve.

FUQITË E OMBUDSMANIT

Ombudsmani ka fuqi të zgjeruara për hetimin e ankesave, duke përfshirë fuqinë për të urdhëruar zyrtarët që t'i dorëzojnë dokumentat ose që t'i përgjigjen pyetjeve.

Nëse Ombudsmani gjen një defekt në administratë, ai mund të rekomandojë që agjencia përgjegjëse ta korrigjojë atë ose i ofron një zgjidhje.

Për shembull, ai mund të rekomandojë që departamenti në fjalë të japë një shpjegim ose të kërkojë të falur, të përshtasë ose të ndryshojë një vendim, të falë një borxh ose të paguajë një dëmshpërblim.

SI TË BËNI NJË ANKESË

Përpara se të kontaktoni zyrën e Ombudsmanit, duhet të përpiqeni ta zgjidhni problemin duke kontaktuar administratën e agjencisë për të cilën keni ankesë, veçanërisht shërbimin e tyre të ankesave nëse e kanë të vlefshëm. Nëse ankoheni për një vendim, përpara duhet të kërkonit rishikim të atij vendimi, nëse është e mundur.

